



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 109 datë 17 qershor 2019

**PER SHTYRJEN E AFATIT PER VERIFIKIMIN E PLOTESIMIT TE KUSHTEVE
LIGJORE NGA KANDIDATET PER PROKUROR TE PERGJITHSHEM TE
REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Në përputhje me nenet 3 paragrafi 4, 17 paragrafi 3, dhe 18 paragrafi 1/b, të Vendimit nr. 50, datë 19.03.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

Neni 1

Të shtyjë afatin për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë deri në përfundimin e procedurës së rivlerësimit për kandidatin Olsian Çela me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Neni 2

Të autorizojë Kryetarin që të caktojë një grup pune të përbërë nga 2 (dy) anëtarë prokurorë të Këshillit dhe 1 (një) anëtar jo prokuror i Këshillit për administrimin formal të dokumentacionit të paraqitur deri tani nga kandidatët dhe institucionet shtetërore si dhe për kërkimin e çdo informacioni shtesë që do të gjykohet i nevojshëm nga grupi i punës, për të cilin kërkohet në çdo rast miratimi i Këshillit.

Në caktimin e përbërjes së grupit të punës Kryetari mban parasysht ngarkesën me punë të anëtarëve të Këshillit dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në grupin e punës.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Gent Ibrahimi